



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR, PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

Nr. 652/6 Prot.

Tiranë, më 24.2.2025

Lënda: Mbi projektet fituese në kuadër të programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”

Drejtuar: Prof. Asoc. Dr. Brunilda Daci,

Drejtor i Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar

Në kuadër të programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” ju informojmë se, në bazë të neneve 40, 108, dhe 109, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 të Statutit të Universitetit të Tiranës, në Vendimin nr. 29 të Senatit Akademik “Për miratimin e Udhëzuesit “Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, që financohen nga Buxheti për Kërkimin Shkencor në UT”, Vendimin e Rektorit të UT-së nr. 13, datë 12.11.2021 “Për miratimin e Komisionit Institucional të Ekspertëve, për vlerësimin e projekteve të Programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”, si dhe thirrjes për projekte në programin “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”, komisioni pasi shqyrtoi dhe vlerësoi dosjet e aplikuar në këtë thirrje, Komisioni Teknik i Vlerësimit të Projekteve në përfundim, përmes Vendimit Nr 1., datë 16.01.2025, shpalli fitues projektet e mëposhtme të aplikuar nga IFBZ:

- Vlerësimi i përqendrimit të radonit dhe studimi i radioaktivitetit alfa/beta total dhe gama spektrometri në ujin e pijshëm për qytetin e Tiranës

Lutemi që informacioni mbi projektin e shpallur fituese të promovohet përmes faqes web të njësisë suaj!

REKTORI

Prof. Dr. Artan Hoxha

